



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 105

Prishtinë, më 13.3.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Boban Todorović.

Munguan : Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 4.3.2013,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtesat në bashkëpronësi,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me shtesën rreth shqyrtimit të kërkesës së Liburn Aliut për të ftuar ministren Mimoza Kusari rreth projektit për Brezovicën në mbledhjen e radhës, kërkesa për shqyrtimin e reagimit të Odës Veterinare të Kosovës, ftesën për ministrin e bujqësisë dhe agjencinë për subvencione rreth kushteve për realizimit të grandeve për mbledhjen e radhës pas datës 18 mars.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.3.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 4.3.2013 me vërejtjen e **Sevdije Lamës** që në këtë procesverbal duhet të figuroi edhe diskutimi i saj ku ka reaguar rreth zonave strikte të mbrojtura të cilat do të ishte më mirë me i shfrytëzua për qëllime ekonomike.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtesat në bashkëpronësi

Kryetari Nait Hasani falënderoi për pjesëmarrje zyrtarët e MMPH dhe rikujtoi komisionin se në mbledhjen e sotme do të duhej që të shqyrtohen edhe tri nene të cilat janë sugjeruar të rregullohen sipas sugjerimeve të MMPH. **Lirie Berisha** sqaroi detalisht për këto ndryshime të kërkuara nga komisioni tek nenet 31,32 dhe 33 duke i kompletuar me sqarimet përkatësisht shtesat e pikave 24,25 tek Përkufizimet. **Kryetari** në vazhdim ftoi komisionin në shqyrtimin përfundimtarë të këtij projektligji dhe u evidentuan disa komente dhe sugjerime të miratuara :

- në vërejtjen e **Liburn Aliut** për hapësira të përbashkëta si dhe ndërtesat çka do të përfshijnë, objektin me tokën apo ndryshe, **Drita Shabani** referoi Nenin 6 pika 1.5 ku përfshihet kjo çështje (Amendamenti 5), ndaj Komisioni konstatoi ndryshimin që duhet të bëhet tek përkufizimet (Amendamenti 2), të fshihet fjalia te pika 12 : “**përbashkëta që sipas marrëveshjes së bashkëpronësisë destinohen**”, njëherit **Lirie Berisha** potencoi faktin se ligj bazik për këto çështje pronësore është Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, dmth ky Ligj nuk do të përfshijë çështjet pronësore. Komente dhe dilema kishin **Kryetari** dhe **Sevdije Lama** si p.sh. për zonat e gjelbëruara, parkingjet para ndërtesave pse paguhën në disa raste etj , të cilat sipas zyrtareve të MMPH i definon përkatësisht sqaron Ligji i cekur më lart për drejtat sendore, ndërsa për parkingje thanë se nuk ka pasur Ligj por edhe është deshtë të shikohet çka ofrohet me kontratë, pastaj të nënshkruhet,
- me sugjerimin e **Kryetarit** tek Neni 33 i propozuar, tek pika 9 fshihet teksti në fund : “**në vlerën e cila së paku mbulon koston e zëvendësimit të plotë të saj.**”, ngase si u tha është fjala për një obligim,
- **Sevdije Lama** kërkoi sqarim për pikën 5 të Nenit 33 rreth siguruesit dhe përfshirjen e hipotekës, mirëpo zyrtarja e MMPH sërish u fokusua tek Ligji për drejtat sendore tek Neni 59.
- **Nenet 31,32 dhe 33 (për Nenin 33 votimi ishte 4 me 1) Komisioni i miratoi** me vërejtjet e cekura më lartë, bashkërisht me vërejtjet nga mbledhja e kaluar, ndaj u vendos që këto amendamente të përcjellën në procedim të mëtejshëm Komisioneve të përhershme.

4. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme u konstatua dhe u vendos si vijon :

- për reagimin e Odës Veterinare të Kosovës ku është konstatuar që në projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësor nuk është përfshirë Oda Veterinare e Kosovës, së pari diskutoi **Liburn Aliu** i cili njoftoi për qëndrimet e Komisionit për Shëndetësi ku është ai anëtarë dhe potencoi se Ligji si model i Gjermanisë është një ligj i përgjithshëm, ndërsa këtu në vendin tonë Oda Veterinare është nën kompetencën e ministrisë së bujqësisë, ndaj çështja se a duhet apo jo një Ligj i veçantë, u sugjerua të ftohen dy ministrat në njërën nga mbledhjet e radhës,
- për mbledhjen e radhës të komisionit më 18 mars të ftohet ministrja Mimoza Kusari rreth projektit master të planit për Brezovicën me të cilin mirët grupi ndërminstor për zbatimin e atij projekti,
- ftesa për ministrin e bujqësisë dhe agjencinë për subvencione rreth kushteve për realizimit të grandeve do të dërgohet për mbledhjen e datës 25 mars.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

